



Pranuar / Dorezuar Punëho/Prodato Received/Delivered	26-10-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHCK	6709/2023		1/2



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1262/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1262/2023 të datës 09.10.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimi/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.10.2023, mori këtë:

### V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar me ankesën A.nr.1262/2023 të datës 09.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesja më datë 05.10.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë nw Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 09.10.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1262/2023 me numër protokolli 6432/2023, me pretendimet për anulimin e njoftimit të datës 04.10.2023 lidhur me konkursin Nr. Referencës: RN00012113 për grupin *Specialist të Administrimit të Përgjithshëm pozita Zyrtar i Gjendjes Civile* të shpallur nga Komuna e Pejës, mirëpo ankuesja më datë 13.10.2023 përmes emailit [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar kërkesë përmes të cilës ka bërë tërheqjen e ankesës së regjistruar më datë 09.10.2023 me numër protokolli 6432/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1262/2023, pasi që ankuesja ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës të datës 09.10.2023.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1262/2023, datë 26/10/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

